UDHËZIM
Nr.3, datë 22.5.2006

PËR KRITERET DHE RREGULLAT E PRIVATIZIMIT TË APARTAMENTEVE TË NDËRTUARA ME FONDET E ISH-FONDACIONEVE PËR FAMILJET QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të vendimit nr.792, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve të ish-fondacioneve për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale", Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Kriteret e shlyerjes së vlerës së banesave, investuar me fondet e ish-fondacioneve në Tiranë dhe Vlorë, konform vendimit nr.792, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të jenë:

a) Koha e shlyerjes 15 vjet.

b) Interesi vjetor 3,5%.

c) Shpenzimet administrative prej 4% që i mbahen familjes për zbatimin e procedurave të pajisjes me banesë, të llogariten në vlerën që duhet të paguajë qytetari e shtrirë në gjithë periudhën e shlyerjes së kredisë.

2. Vlera e banesës të llogaritet bazuar në:

a) verën e investimit, e përcaktuar në vendimin nr.792, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave;

b) vlerën e truallit sipas asetit, që i takon objektit;

c) vlerën e investuar për infrastrukturën;

d) vlerën e pagesave për leje dhe rinovim leje ndërtimi, leje shfrytëzimi dhe regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Mjediset e katit përdhe që nuk janë objekte banimi, të shiten në tregun e lirë sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

4. Vlera nga shitja e ambienteve të katit përdhe të kalojë për mbulimin e vlerës së:

- asetit e cila do të kalojë për llogari të kreditorëve të shoqërisë "Vefa";
- investimit për ambientet e katit përdhe.

5. Në rastin kur fitimi neto, nga shitja e ambienteve të katit përdhe, nuk arrin të mbulojë plotësisht vlerën e asetit, kjo diferencë të merret nga të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamenteve dhe të kalojë në llogari të kreditorëve të shoqërisë "Vefa".

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT **Lulzim Basha**	MINISTRI I FINANCAVE **Ridvan Bode**